



Република Македонија  
НАРОДЕН ПРАВОБРАНИТЕЛ

Republika e Maqedonisë  
AVOKATI I POPULLIT

**O M B U D S M A N**  
Republic of Macedonia

Më datë 23.03.2017, Mekanizmi Parandalues Nacional realizoi vizitë të rregullt të paparalajmëruar në Stacionin Policor Draçevë.

Vizita rezultoi nga mandati i Avokatit të Popullit - Mekanizmi Parandalues Nacional, i parashikuar në Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës dhe Trajtimeve tjera Brutale, Johumane, Nënçmuese ose Ndëshkuese. Me Protokollin Fakultativ përkufizohet realizimi i rregullt i vizitave në vendet ku mund të kryet privimi nga liria, me qëllim të identifikimit të rreziqeve për shkak të parandalimit të torturës ose llojeve tjera të trajtimeve brutale, jonjerëzore, nënçmuese ose ndëshkuese.

Ekipi i MPN-së realizoi bashkëpunim të mirë dhe kooperativ me nëpunësit zyrtarë të punësuar në Stacionin policor, të cilët mundësuan qasje papengesë deri te të gjitha hapësirat dhe instalimet dhe këqyrje mbi dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë këqyrjes në hapësirat e zyrave të nëpunësve dhe hapësirat e tjera të Stacionit policor, nga ana e ekipit të MPN-së nuk u vërejtën mjete, dhe as sende të tjera të dyshimta me të cilat do të mund të kryhej frikësimi i personave të arrestuar, përkatësisht personave të privuar nga liria dhe personave të ndaluar.

Ekipi i MPN-së u informua se për nëpunësit policorë organizohen trajnime të rregullta dhe të vazhdueshme në tema të ndryshme tematike.

Ekipi i MPN-së përsëri konstatoi se hapësirat e ndalimit, për të cilat në vitin 2012 u miratua vendim që të mos përdoren për këtë qëllim, ende janë të vulosura, me çka nuk përjashtohet rreziku që të njëjtat të jenë ose të përdoren për ndalim.

Ekipi i MPN-së konstatoi se ky Stacion policor nuk ka në dispozicion hapësirë të posaçme për biseda me personat e arrestuar dhe personat e privuar nga liria, si dhe nuk ka hapësirë për marrje në pyetje dhe për biseda me personat e mitur, siç është parashikuar në Ligjin për drejtën e fëmijëve.

Nuk janë theksuar udhëzimet për të drejtat e personave të arrestuar dhe personat e privuar nga liria në të gjitha hapësirat në të cilat zhvillohen biseda me këta persona.

Në Stacionin policor nuk ka tualete të posaçme për personat e arrestuar, përkatësisht personat e privuar nga liria.

Në asnjërën nga hapësirat, në të cilat zhvillohet marrja në pyetje, nuk ka të instaluar sistem për audio ose video monitorim.

Gjatë kësaj vizite, Ekipi i MPN-së konstatoi gjendje jashtëzakonisht të keqe materiale në SP Draçevë, e që seriozisht e vë në pikëpyetje funksionimin normal dhe të rregullt këtë Stacion Policor.

Ekipi i MPN-së konstatoi se dokumentacioni zyrtar i këtij Stacioni policor nuk është në nivel të kënaqshëm, si dhe në të nuk mbahen evidenca të sakta dhe precize të të gjitha ngjarjeve dhe fakteve.

Për këtë vizitë, Mekanizmit Parandalues Nacional hartoi Raport të posaçëm në të cilin i konstatoi gjendjet pozitive dhe negative dhe dha rekomandime konkrete deri te Ministria e Punëve të Brendshme, si dhe deri te komandanti i Stacionit policor Draçevë, me qëllim që të eliminohen mangësitë e sugjeruara dhe të përmirësohen kushtet dhe trajtimi i personave të privuar nga liria, personave të arrestuar dhe personave të ndaluar.